



Politizimi i KPM-së (Analizë e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave)



Autorë: Gzim Shala dhe Florian Smajli

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Rockefeller Brothers Fund.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Korrik, 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

| | | |
|-----|---------------------------------------|----|
| 1. | Përmbledhje ekzekutive | 7 |
| 2. | Pavarësia e KPM-së | 8 |
| 3. | Nevoja për miratimin e Ligjit për KPM | 9 |
| 4. | Ligji për KPM | 10 |
| 5. | Rritja e numrit të anëtarëve | 12 |
| a. | Pa arsyeshmëria | 12 |
| b. | Ndërhyrja | 13 |
| 6. | Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së | 15 |
| 7. | Shkarkimi i anëtarëve të KPM-së | 16 |
| 8. | Zgjedhja e Kryetarit | 18 |
| 9. | Si u politizua KPM? | 19 |
| 10. | Cenimi i barazisë gjinore | 20 |

SHKURTESAT

KPM – Komisioni i Pavarur për Media

KiE – Këshilli i Evropës

BE – Bashkimi Evropian

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KGjK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Komisioni Parlamentar për Media – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal

IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi

1. Përmbledhje ekzekutive

Më 11 Korrik 2024, Kuvendi miratoi Ligjin për KPM-në. Nga analizimi i këtij Ligji, IKD ka gjetur se pavarësia e garantuar me Kushtetutë për një institucion të pavarur si KPM, tjetërsohet në varësi të këtij institucioni ndaj partisë në pushtet. Kjo qasje është e rrezikshme dhe cenon drejtpërdrejtë vlerat dhe parimet e demokracisë të mishëruara në Kushtetutën e Kosovës. Mënyra e veprimit lidhur me miratimin e Ligjit për KPM-në tregon se miratimi i tij ishte qartazi vullnet i vetëm pozitiv, pasi me këtë Ligj nuk u pajtuan opozita, partnerët ndërkombëtarë, mediat dhe shoqëria civile, dhe duke mos respektuar obligimet lidhur me zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik lidhur me këtë projektligj kaq të rëndësishëm për demokracinë dhe lirinë e mediave në Kosovë.

Ligjit për KPM-në i paraprinë një sulm i papranueshëm i Kuvendit ndaj KPM-së, përfshirë kampanjën e paparë ndonjëherë që nga shpallja e pavarësisë ku eksponentëve të partisë në pushtet fillojnë fushatë të orkestruar ndaj Kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së, duke i akuzuar edhe për tradhti kombëtare dhe gjuhë tjetër të papërshtatshme ndaj një mekanizmi të pavarur kushtetues. Ligji duket se vazhdon këtë qasje në raport me KPM-në, duke e politizuar tërësisht këtë institucion të pavarur kushtetues. KPM është institucion i pavarur kushtetues dhe ka një rëndësi të veçantë për demokracinë dhe lirinë e mediave në Kosovë. Për të funksionuar në mënyrë adekuate, si institucion i pavarur kushtetues, KPM duhet të gëzojë pavarësinë e saj ligjore dhe praktike. Nevojën për ruajtjen e kësaj pavarësie e ka konfirmuar edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe Direktiva e Bashkimit Evropian për Shërbimet Mediale Audio-Visuale.

Ligji për KPM shkatërron tërësisht pavarësinë kushtetuese të këtij institucioni, duke e shndërruar këtë institucion si një institucion vartës të Kuvendit dhe lehtë të ndikueshëm nga Qeveria. Sipas Ligjit, anëtarët e KPM-së zgjidhen përmes një procedurë të udhëhequr nga një Komision Parlamentar derisa votimi i tyre bëhet me shumicë të thjeshtë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Kështu, këto dispozita garantojnë një proces të lehtë për partinë që ka shumicën në Kuvend që ta politizojë përbërjen e KPM-së. Në anën tjetër, Ligji për KPM i la mundësi Kuvendit edhe të shkarkojë anëtarët e KPM-së, në secilin rast kur Komisioni Parlamentar humb besimin ndaj anëtarëve të KPM-së. Këto kritere, i mundësojnë shumicës parlamentare që në çdo kohë të ndryshojë përbërjen e KPM-së. Kjo situatë i vendos në presion të vazhdueshëm të gjithë anëtarët e këtij institucioni. Roli i Kuvendit në KPM shtrihet deri në nivelin që edhe e zgjedh Kryetarin e saj, përkundër se kjo nuk ndodh me institucionet e tjera kolegjiale dhe përkundër faktit se kompetenca e KPM-së për zgjedhjen e Kryetarit të saj është kompetencë e natyrshme e një institucioni kolegjial. Kjo qasje e re në ligj, zhvlerëson tërësisht garancinë kushtetues mbi pavarësinë funksionale të KPM-së, duke marr kompetenca nga ky institucion i pavarur dhe duke ia deleguar deputeteve të partisë ose koalicionit qeverisës që ka shumicën në Kuvendin e Kosovës. Kjo mënyrë e rregullimit e bën lehtësisht të cenueshëm dhe të ndikueshëm KPM-në. Se sa mund të keqpërdoret kjo në praktikë, mjafton të shohim debatin, sulmet dhe kërkesat e deputetëve të partisë në pushtet në raportimin e anëtarëve të KPM-së në Komisionin Parlamentar për Media gjatë këtij viti.

2. Pavarësia e KPM-së

Kapitulli XII i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton pavarësinë dhe funksionalitetin e institucioneve të pavarura kushtetuese. Në kuadër të këtij kapitulli bënë pjesë edhe Komisioni i Pavarur i Mediave. Sipas Kushtetutës [neni 141] “1. Komisioni i Pavarur i Mediave është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. 2. Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Mediave zgjedhën sipas ligjit, përmes një procesi transparent”.

Vet përcaktimi i KPM si institucion i pavarur kushtetues i jep këtij institucioni pozitë të veçantë në infrastrukturën institucionale në rendin kushtetues dhe juridik kosovar. Pavarësia e këtyre institucioneve në përgjithësi dhe i KPM-së në veçanti **ka interes jetik për parimet dhe vlerat që promovojnë demokracinë, lirinë e fjalës dhe medias në një shoqëri demokratike** çfarë aspiron Republika e Kosovës edhe përmes obligimeve ndërkombëtare që ka marrë përsipër përmes marrëveshjes për Stabilizim Asocim me Bashkim Evropian.

Mbrojtjen e veçantë kushtetuese të pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese e ka konfirmuar në vazhdimësi edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese theksoi se “Kushtetuta është e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Përveç tri degëve të pushtetit, legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësorit të rregullt, Kushtetuta i garanton status special Zyrës së Avokatit të **Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në Kapitullin XII** të Kushtetutës. Kushtetuta, gjithashtu, ia garanton statusin special Gjykatës Kushtetuese, si garantues dhe interpretues përfundimtar i Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Kushtetuese nuk janë pjesë e legjislativit, e ekzekutivit dhe e gjyqësorit të rregullt. **E njëjta vlen për institucionet e tjera të pavarura të përmendura në Kapitullin XII të Kushtetutës**”¹.

Tutje, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kushtetuta u vë obligim organeve të shtetit, nëpërmjet mjeteve legjislative dhe mjeteve të tjera, që të sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë, dinjitetin dhe efektshmërinë e Zyrës së Avokatit të Popullit **dhe të institucioneve të tjera të pavarura**², duke shtuar se Qeveria nuk mund të mjaftohet duke aplikuar kritere identike me ato që aplikohen për agjencitë qeveritare, t'i aplikojë në mënyrë të njëjtë edhe për institucionet e pavarura të definuar në Kushtetutë.

Kështu, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, tanimë është etabluar mbrojtja e veçantë që Kushtetuta ua njeh institucioneve të pavarura kushtetuese, ku bënë pjesë edhe KPM-ja. Për këtë arsye, në çfarëdo rrethane, Kushtetuta nuk lejon cenimin e pavarësisë së KPM-së dhe

¹ Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin rastin nr. KO203/19. Faqe 135. (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/ko_203_19_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

² Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese në rastin rastin nr. KO73/16. Faqe 70 dhe 74. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13155>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese nga një institucion tjetër. Kështu, sipas Kushtetutës, KPM duhet të ketë pavarësinë e saj të funksionimit ashtu që duhet të jetë e ndarë ligjërisht dhe praktikisht nga institucionet e tjera publike.

Në anën tjetër, Direktiva e Bashkimit Evropian për Shërbimet Mediale Audio Vizuele thekson se organet rregullatore kombëtare, në rastin tonë KPM, duhet të jenë të ndryshme nga qeveria. Sipas kësaj direktive, Autoritetet ose organet rregullatore kombëtare duhet të konsiderohet se kanë arritur shkallën e nevojshme të pavarësisë nëse ato autoritete ose organe, duke përfshirë ato që janë krijuar si autoritete ose organe publike, janë funksionalisht dhe efektivisht të pavarura nga qeveritë e tyre përkatëse dhe nga çdo organ tjetër publik ose privat. Kjo konsiderohet thelbësore për të siguruar paanshmërinë e vendimeve të marra nga një autoritet ose organ rregullator kombëtar³.

Këshilli i Evropës njihë rolin e rëndësishëm të autoriteteve të pavarura rregullatore, të cilave u është besuar përgjegjësia për rregullimin e sektorit audio-vizual në nivel kombëtar, si kontribues në drejtim të nxitjes së një mjedisi të favorshëm për lirinë e shprehjes. Gëzimi i pavarësisë së vërtetë ligjore dhe praktike është një parakusht që këto autoritete të jenë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive, transparente dhe të përgjegjshme⁴.

3. Nevoja për miratimin e Ligjit për KPM

Aktualisht, KPM funksionon me Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2012. Duke u bazuar në rrjedhën e zhvillimeve në fushën mediale, ky Ligj më nuk i përshtatet realitetit dhe nevojës për të përmirësuar këtë sferë në pajtim me zhvillimet e reja që kanë ndodhur në vitet e fundit. Për këtë arsye, miratimi i Ligjit të ri për KPM, në pajtim me vlerat dhe parimet që i promovon Kushtetuta e Kosovës është mesë legjitim dhe i domosdoshëm. Për më tepër edhe vet Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën ndryshimin e këtij ligji e cilëson si proces të vonuar. Ky raport thekson nevojën e harmonizimit të Ligjit për KPM me Direktivën për Shërbimet Mediale Audio-Vizuele.

Sa i përket direktivës në fjalë, Projektligji fillestar për KPM, i miratuar në Qeveri [neni 2.2], theksonte se “Ky ligj është në përputhshmëri të plotë me Direktivën (EU) 2010/13/EU për Shërbimet Mediale Audio-Vizuele dhe Direktivën (EU) 2018/1808”. Ky nen u ndryshua gjatë trajtimit të tij në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ashtu që u theksua se Projektligji për KPK është vetëm pjesërisht në përputhje me këtë direktivë.

Megjithatë, nevoja për miratimin e Ligjit të ri për KPM nuk nënkupton mundësinë e Kuvendit për të minuar pavarësinë Kushtetuese të KPM-së. Ligji i ri për KPM duhet t’i përshtatet nevojave të saja dhe zhvillimeve të reja. Nëse kjo nuk ndodhë, atëherë rrezikohet që pikërisht Ligji i ri për KPM të degradojë punën e këtij institucioni të pavarur kushtetues.

³ ³ “DIRECTIVE (EU) 2018/1808 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 14 November 2018”, paragrafi 53. (Shih linkun: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX%3A32018L1808>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

⁴ Këshilli i Evropës “Autoritetet Rregullatore të Medias”. (Shih linkun: <https://rm.coe.int/leaflet-regulatory-authorities-en/168079cede>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

4. Ligji për KPM

Më 15 nëntor 2021, në platformën e konsultimeve publike, Zyra e Kryeministrit publikoi për konsultime publike Projektligjin për KPM-në. Afati për konsultime publike përfundoi më 3 dhjetor 2021. Në atë kohë, në fuqi ishte Rregullorja Nr.05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Kjo rregullore e obligonte Zyrën e Kryeministrit të publikonte projekt propozimin e përditësuar, si dhe raportin përfundimtar të konsultimit me publikun⁵. Versioni i përditësuar dhe raporti përfundimtar i konsultimeve me publikun nuk u publikuan asnjëherë në platformën e konsultimeve publike⁶.

Që nga përfundimi i procesit të konsultimeve publike, Qeveria nuk njoftoi për zhvillimet në lidhje me këtë Projektligj. Mbi 2 vite më vonë, me vendimin e 27 dhjetorit të vitit 2023⁷, Qeveria kishte miratuar Projektligjin për KPM. Ky Projektligj iu dorëzua Kuvendit më 11 janar 2024.

Kështu, në mes të procesit të përfundimit të procesit të konsultimeve publike dhe miratimit të Projektligjit në Qeveri kaluan mbi 2 vite, gjatë të cilave Qeveria nuk informoi lidhur me zhvillimet për këtë Projektligj. Nëse krahasojmë versionin e publikuar për konsultime publike me versionin e miratuar në Qeveri, vërehen ndryshime substanciale.

Përderisa sipas Projektligjit të publikuar për konsultime publike [neni 11] KPM përbëhej nga 7 anëtarë, kurse sipas Projektligjit të miratuar në Qeveri [neni 13] KPM përbëhet nga 11 anëtarë. Sipas Projektligjit të publikuar për konsultime publike [neni 11, paragrafi 5] përcaktohej se në përbërje të KPM-së duhet të jenë së paku dy anëtarë të gjinisë femërore. Ndërsa, sipas Projektligjit të miratuar në Qeveri [neni 13], nuk përcaktohet se sa anëtarë të gjinisë femërore duhet të jenë së paku në përbërje të KPM-së.

Ndryshime mes këtyre dy projektligjeve kishte edhe në procedurën e zgjedhjes së anëtarëve. Në Projektligjin e publikuar për konsultime publike [neni 12] kandidaturat e pranuar shqyrtohen nga një Komision Ad – hoc i Kuvendit të Kosovës, i cili Komision më pas i propozon nga dy kandidatë për çdo pozitë. Ndërkaq, në Projektligjin e miratuar në Qeveri [neni 14], përcaktohet që kandidaturat e pranuar për anëtarë të KPM-së, shqyrtohen nga Komisioni Parlamentar për Media, e që i njëjti më pas i propozon nga dy anëtarë për çdo pozitë.

Gjithashtu, ndryshime mes dy projektligjeve vërehen edhe në procedurën dhe bazat për shkarkimin e anëtarëve. Sipas Projektligjit të publikuar për konsultime publike [neni 15] propozimi për shkarkim vije nga KPM me shumicën e thjeshtë të numrit të anëtarëve ose/dhe ndonjë iniciativë tjetër nga jashtë. Ndërsa, në Projektligjin e miratuar në Qeveri [neni 17],

⁵ Qeveria, Rregullorja Nr.05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, neni 15.3.3.3.

⁶ Qeveria, Platforma e Konsultimeve Publike. (Shih linkun: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41259>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

⁷ Vendim i Kuvendit. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/289Vendimpermiratimneparim_5TrhVDvJxK.pdf). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

propozimi për shkarkim vije nga Komisioni Parlamentar për Media, për të cilin propozim pastaj Kuvendi i Kosovës vendos me shumicë të thjeshtë.

Po ashtu, në Projektligjin e miratuar në Qeveri [neni 17], si bazë për iniciimin e shkarkimit të Kryetarit apo anëtarëve tjerë të KPM-së është edhe humbja e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit. Shkarkimi i Komisionit mund të iniciohej edhe në rast të mosmiratimit të raportit vjetor të KPM-së nga Kuvendi. Këto baza për shkarkim të kryetarit apo anëtarëve të KPM-së nuk kishin qenë të përfshira në Projektligjin e publikuar për konsultime publike.

Për këtë arsye, Qeveria realizoi vetëm një proces formal të konsultimeve, në atë mënyrë që dispozitat më problematike i “kontrabandoi” në Kuvend.

Pas shqyrtimit të parë të Projektligjit për KPM-në në seancat plenare të Kuvendit të mbajtura më 15 shkurt dhe 7 mars, ky Projektligj ishte miratuar në parim⁸.

Ndërsa, gjatë shqyrtimit të këtij Projektligji, Komisioni Parlamentar për Media kishte ndërprerë mbledhjen e 26 prillit 2024 me qëllim që të pranohej një opinion nga Këshilli i Evropës. Pas raportit të ekspertëve të KiE-së, Zyra e BE-së në Kosovë dhe OSBE i rekomanduan Kuvendit që të nisë një draft të ri të Ligjit për KPM⁹. Pas këtij reagimi, përmirësimin e këtij Projektligji e kishte kërkuar edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, mes tjerash duke thënë se ky “qortim” nga ana e KiE-së është rezultat i tendencës së Qeverisë dhe shumicës parlamentare për të kontrolluar mediat dhe KPM-në¹⁰.

Komisioni Parlamentar për Media vazhdoi me shqyrtimin e këtij Projektligji dhe votimin e amendamenteve më 27, 28 dhe 30 maj 2024. Raporti me amendamente u miratua më pas edhe nga katër Komisionet e Përhershme, si ai për Buxhet dhe Financa, për Legjislacion, për Integrim Evropian, si për të Drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Më 26 qershor 2024, në lidhje me Projektligjin kishte reaguar edhe Zyra e BE në Kosovë. Në këtë reagim, mes tjerash thuhej se versioni aktual nuk e pasqyron shumicën e rekomandimeve të përfshira në Opinionin Ligjor të përgatitur nga KiE, duke përfshirë çështjet delikate siç janë kompetencat dhe financimi i KPM-së, procedurat zgjedhore dhe afatet e shërbimit për anëtarët e vet, si dhe proporcionaliteti i sanksioneve¹¹. Në po të njëjtën ditë kishte reaguar edhe Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, i cili kishte deklaruar se shumica e

⁸ Vendim i Kuvendit. (Shih linkun: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/289Vendimpermiratimneparim_5TrhVDvJxK.pdf). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

⁹ “Zyra e BE-së në Kosovë dhe OSBE i rekomandojnë Kuvendit të nis një draft të ri të ligjit për KPM, pas raportit të ekspertëve të KiE-së”, Betimi për Drejtësi, 27 maj 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zyra-e-be-se-ne-kosove-dhe-osbe-i-rekomandojne-kuvendit-te-nis-nje-draft-te-ri-te-ligjit-per-kpm-pas-raportit-te-eksperteve-te-kie-se/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹⁰ Po aty.

¹¹ Zyra BE në Kosovë/Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së në Kosovë “BE-ja në Kosovë shprehet në lidhje me Projektligjet për Zyrtarët Publikë, Komisionin e Pavarur për Media dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës”, 26 qershor 2024. (Shih linkun: <https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/be-ja-n%C3%AB-kosov%C3%AB-shprehet-n%C3%AB-lidhje-me-projektligjet-p%C3%AB-zyrtar%C3%ABt-publik%C3%AB-komisionin-e-pavarur-p%C3%AB-sq?s=321>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

rekomandimeve nga BE dhe KiE janë injoruar, duke kërkuar nga Kuvendi që t'i rishqyrtojë amendamentet e votuara para shqyrtimit¹².

Më 11 korrik 2024, shqyrtimi i Projektligjit në seancë plenare ishte njëra ndër pikat e rendit të ditës. Kuvendi miratoi Ligjin në lexim të dytë, më 59 vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime. Ndërkaq, opozita kishte liruuar sallën pas refuzimit të kërkesës së tyre që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës.

Miratimi i Ligjit nga ana e Kuvendit ngjalli shumë reagime edhe nga OSBE¹³, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës¹⁴, Rrjeti për të Drejtat e Njeriut¹⁵, Shefi i Zyrës së BE në Kosovë, Tomas Szunyog dhe Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde¹⁶.

Kështu, kjo mënyrë e veprimit tregon se miratimi i Ligjit për KPM ishte qartazi vullnet i vetëm pozitës, pasi me këtë Ligj nuk u pajtuan opozita, partnerët ndërkombëtarë, mediat dhe shoqëria civile dhe duke mos respektuar obligimet lidhur me zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik lidhur me këtë ligj kaq të rëndësishëm për demokracinë dhe lirinë e medias në Kosovë.

5. Rritja e numrit të anëtarëve

a. Pa arsyeshmëria

Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media [neni 10], parasheh që KPM të përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët zgjedhen me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Kosovës. Ndërkaq, Projektligji i miratuar [neni 13] e rrit numrin e anëtarëve të KPM-së në 11 anëtarë. Mirëpo, rritja e këtij numri ka ardhur pa asnjë analizë përkatëse përkitazi me nevojën për rritjen e numrit të anëtarëve të KPM-së. Për më tepër, rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së, në kontekst të funksionimit të saj, nuk gjënë asnjë mbështetje logjike.

Fillimisht, duhet theksuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës deri më tani nuk ka arritur të plotësojë KPM-në as sipas përbërjes aktuale me shtatë anëtarë. Madje, dështimet e Kuvendit

¹² “Projektligjet për Zyrarë Publikë, KPM dhe KPK, Rohde: Shumica e rekomandimeve të BE-së janë injoruar”, **Betimi për Drejtësi**, 26 qershor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/projektligjet-per-zyrtare-publike-kpm-dhe-kpk-rohde-shumica-e-rekomandimeve-te-be-se-jane-injoruar/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹³ “OSCE Mission in Kosovo statement on the new Law on the Independent Media Commission”, 11 korrik 2024. (Shih linkun: [OSCE Mission in Kosovo statement on the new Law on the Independent Media Commission | OSCE](https://osce.org/missions/kosovo/statement-on-the-new-law-on-the-independent-media-commission)). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹⁴ “AGK: Miratimi i Ligjit për KPM-në, goditje ndaj lirisë së medias dhe tentim për disiplinim e kontroll të tyre”, 11 korrik 2024. (Shih linkun: [AGK: Miratimi i Ligjit për KPM-në, goditje ndaj lirisë së medias dhe tentim për disiplinim e kontroll të tyre | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës - AGK \(agk-ks.org\)](https://www.agk-ks.org/2024/07/11/miratimi-i-ligjit-per-kpm-ne-goditje-ndaj-lirise-se-medies-dhe-tentim-per-disiplinim-e-kontroll-te-tyre/)). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹⁵ “Projektligji për KPM nuk duhet të hyjë në fuqi”, Human Rights Network, 13 korrik 2024. (Shih linkun: <https://www.facebook.com/share/R8bYscb3hsf63ZEC/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹⁶ “OSBE: Shumica e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë nuk janë marrë parasysh në Ligjin për KPM-në”, **Betimi për Drejtësi**, 11 korrik 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/osbe-shumica-e-rekomandimeve-te-eksperteve-nderkombetare-nuk-jane-marre-parasysh-ne-ligjin-per-kpm-ne/>) (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

të Republikës së Kosovës për të zgjedhur anëtarët e KPM-së kishin lënë këtë institucion jofunksional që nga 16 tetor 2022 e deri më 24 maj 2023. Kjo për shkak se Komisioni në mungesë të kuorumit, i pamundësohej zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit. Mirëpo, edhe pse kanë kaluar më shumë se një vit që nga funksionalizimi i KPM-së, numri prej shtatë (7) anëtarëve nuk është plotësuar asnjëherë, e që edhe aktualisht KPM ka vetëm pesën (5) anëtarë.

Duke pasur parasysh vështirësitë që paraqiten deri në zgjedhjen e një anëtari të KPM-së dhe praktikën e deritanishme, rritja e numrit të anëtarëve të këtij institucioni lehtëson defunksionalizimin e tij, për shkak të mos përzgjedhjes së numrit të nevojshëm të anëtarëve të KPM-së. Kjo pasi ngritja e numrit të anëtarëve të KPM-së reflekton edhe në kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje, që nga katër shkon në gjashtë.

Më 12 qershor të këtij viti, për konkursin e fundit për dy anëtarë të KPM-së (një shqiptar dhe një nga komunitetet jo shumicë), Komisioni Ad-hoc kishte konstatuar se nuk ka mjaftueshëm kandidatë që kanë plotësuar kriteret, duke sugjeruar KPM-në që ta rishpallë konkursin¹⁷. Po ashtu, kishte dështuar edhe një konkurs paraprak për zgjedhjen e dy anëtarëve të KPM-së. Më 4 mars 2024 ishte planifikuar që të bëhej intervistimi i kandidatëve që kanë plotësuar kriteret, mirëpo kishte dështuar për shkak se një kandidate ishte tërhequr nga gara për anëtare të KPM-së¹⁸.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh që KPM kryesisht vetëm shqyrton dhe voton në lidhje me rekomandimet e paraqitura nga Zyra Ekzekutive e KPM-së, atëherë rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së nuk ndikon në rritjen e efikasitetit të këtij institucioni. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të KPM-së, më adekuate është fuqizimi i Zyrës Ekzekutive, se sa rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së.

Tutje, meqenëse anëtarët e KPM-së zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk mund të konsiderohet se rritja e numrit të anëtarëve të KPM synon ngritjen e pavarësisë së këtij institucioni.

Për të gjitha këto arsye, rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së është një vendim i pambështetur në një analizë reale dhe nuk përkon me nevojat e funksionimit adekuat të KPM-së.

b. Ndërhyrja

Përkundër mungesës së analizës, nevojës dhe arsyeshmërisë, Projektligji për KPM ngriti numrin e anëtarëve të saj nga 7 në 11. Nisur nga kjo situatë dhe mënyrave se si Qeveria dhe Kuvendi kanë tentuar të veprojnë apo kanë vepruar në të kaluarën edhe me institucione tjera të

¹⁷ “Komisioni Ad-hoc: S’ka mjaftueshëm kandidatë, KPM të rishpallë konkursin për dy anëtarë”, Betimi për Drejtësi, 12 qershor 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/komisioni-ad-hoc-ska-mjaftueshem-kandidate-kpm-te-rishpalle-konkursin-per-dy-anetare/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

¹⁸ “Dështon intervistimi për përzgjedhjen e dy anëtarëve të KPM-së, rekomandohet rishpallja e konkursit pasi një kandidate u tërhoq nga gara”, Betimi për Drejtësi, 4 mars 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/nje-kandidate-terhoqet-nga-gara-desh-ton-konkursi-per-perzgjedhjen-e-dy-anetareve-te-kpm-se/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

pavarura, krijon bindjen se kemi të bëjmë me një tendencë për cenimin e pavarësisë së KPM-së.

Deri më tani, Qeveria dhe Kuvendi kanë dëshmuar tendencën e tyre për cenimin e pavarësisë së institucioneve kushtetuese përmes rritjes së numrit të anëtarëve. Një tendencë e tillë është shprehur për shembull në rastin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, që nga ideja për uljen e numrit të anëtarëve në shtatë, erdhi Projektligji i ri që ngriste numrin e anëtarëve në 19. Këto ndryshime nuk ishin përkrahur nga Komisioni i Venecias¹⁹ dhe si të tilla nuk u miratuan nga Kuvendi.

Në anën tjetër, duhet theksuar se Projektligjit për KPM i paraprinë një sulm i papranueshëm i Kuvendit ndaj KPM, përfshirë kampanjës së paparë ndonjëherë që nga shpallja e pavarësisë ku eksponentëve të partisë në pushtet fillojnë fushatë të orkestruar ndaj kryetarit të KPM dhe anëtarëve të KPM duke i akuzuar edhe për tradhti kombëtare dhe gjuhë tjetër të papërshtatshme ndaj një mekanizmi të pavarur kushtetues²⁰. Në lidhje me këto sulme, shoqëria civile kishte reaguar pas një mbledhje të Komisionit Parlamentar për Media, duke dënuar ashpër ndërhyrjen politike në punën e KPM-së²¹. Në këtë reagim, mes tjerash thuhet se deputetët e pozitës ushtruan presion publik të paprecedent ndaj anëtarëve të KPM-së lidhur me miratimin e vendimeve që hyjnë në fushëveprimtarinë e këtij institucioni të pavarur kushtetues. Gjithashtu, në këtë reagim thuhet se përveç kësaj, është cenuar edhe integriteti dhe dinjteti personal i anëtarëve të këtij institucioni kushtetues, në këtë rast KPM-së.

Në këtë situatë, mënyra e sjelljes së deputetëve të partisë në pushtet, vullnet i vetëm të cilës ishte miratimi i Ligjit për KPM-së, tregon për pakënaqësi të tyre me përbërjen aktuale të këtij institucioni.

Në KPM aktualisht janë pesë anëtarë të zgjedhur. Sipas Ligjit [neni 14], procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të KPM-së është e thjeshtë dhe të njëjtit zgjidhen me shumicë të thjeshtë të votave. Kështu, zgjedhja e gjashtë anëtarëve të tjerë, për të mbërritur numri i anëtarëve në 11, i defaktorizon anëtarët aktualë të KPM-së përballë gjashtë anëtarëve të rinj të zgjedhur.

¹⁹ “Komisioni i Venecias s’i përkrahu ndryshimet e MD-së për rritjen e përkohshme të anëtarëve të KPK-së në 19 deri në janar të vitit 2026”, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 20 dhjetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-dhe-fol-komisioni-i-venecias-si-perkrahu-ndryshimet-e-md-se-per-rritjen-e-perkohshme-te-anetareve-te-kpk-se-ne-19-deri-ne-janar-te-vitit-2026/>) (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

²⁰ “Basha i VV-së vazhdon sulmet ndaj KPM-së”, Nacionale, shkurt 2024. (Shih linkun: <https://nacionale.com/live/basha-i-vv-se-vazhdon-sulmet-ndaj-kpm-se>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).; “Dimal Basha akuzon rëndë Bordin e KPM-së: Kam informata, dikush prej juve është shitur”. Paparaci, 9 shkurt 2024. (Shih linkun: <https://paparaci.com/404826/dimal-basha-akuzon-rende-bordin-e-kpm-se-kam-informata-dikush-prej-juve-eshte-shitur/>). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

²¹ “Shoqëria civile reagon pas mbledhjes së Komisionit Parlamentar: Dënojmë ashpër ndërhyrjen politike në punën e KPM-së”, Betimi për Drejtësi, 9 shkurt 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shoqeria-civile-reagon-pas-mbledhjes-se-komisionit-parlamentar-denojme-ashper-nderhyrjen-politike-ne-punen-e-kpm-se/>) (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

Për këto arsye, në bazë të këtyre rrethanave, rritja e numrit të anëtarëve të KPM-së i ngjanë tendencës për politizim të plotë dhe të shpejtë të KPM-së. Në fakt, nga analiza holistike e kësaj çështje, nuk evidentohen ndonjë arsye tjetër për ngritjen e numrit të anëtarëve të KPM.

6. Zgjedhja e anëtarëve të KPM-së

Projektligji për KPM nuk ka përcaktuar asnjë standard adekuat për t'i krijuar pavarësi objektive KPM-së. Dispozitat që kanë të bëjnë me procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të KPM-së mundësojnë partinë në pushtet që lehtësisht ta politizoj atë.

Sipas Ligjit për KPM [neni 14] konkursi shpallet nga KPM, derisa kandidaturat e pranuar për kryetar dhe ata për anëtarë shqyrtohen nga Komisioni përkatës për media i Kuvendit të Kosovës, i cili Komision pas zhvillimit të intervistave, i rekomandon Kuvendit votimin e dy kandidatëve për çdo pozitë të lirë. Ndërsa, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicë të thjeshtë të votave, përkatësisht shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Në këtë situatë, Projektligji e ka lehtësuar politizimin e KPM-së përmes përzgjedhjes së anëtarëve të saj. Secila Qeveri e ka të paktën shumicën absolute në Kuvend, pa të cilën nuk mund të qëndrojë. Ndërsa, për përzgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, nevojitet vetëm shumica e thjeshtë e votave. Potencialisht, një anëtar i KPM-së mund të zgjidhet më 31 vota. Për këtë arsye, Projektligji për KPM në mënyrë të hapur lë mundësinë e politizimit të këtij institucioni për secilën Qeveri.

Sa i përket shumicës së kërkuar për përzgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, Kushtetuta e Republikës së Kosovës [neni 80.1] ka përcaktuar se “*Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë kushtetutë*”. Për përzgjedhjen e anëtarëve të KPM-së, nuk ka një dispozitë specifike kushtetuese që lejon përcaktimin e një shumice tjetër të votimit.

Megjithatë, në një opinion ndaj Bullgarisë (*ku edhe atje rregullohet kjo çështje me Kushtetutë njësoj si në Kosovë*), Komisioni i Venecias kishte theksuar se “një gjykatë kushtetuese nacionale zakonisht ndërhyr kur ka mungesë të një garancioni, e jo kur ligji i zakonshëm parashikon një garancion më të rreptë, si në rastin konkret, i cili do të përforconte pavarësinë dhe karakterin përfaqësues”....” Prandaj, Komisioni i Venecias rekomandonte rikthimin e përcaktimit ligjor të shumicës së kualifikuar në rastin që trajtonte ky opinion²². Kështu, përshtatshëm, një standard i tillë mund të aplikohet edhe në rastin e KPM-së ashtu që përcaktimi i një shumice të kualifikuar për votimin e anëtarëve të KPM-së nuk do të konsiderohej si kundërkushtetuese. Madje, aktualisht, ka Ligje në fuqi që përmbajnë dispozita të tilla. Shembull për këtë janë dispozitat që kanë të bëjnë me shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku për shkarkimin e të njëjtëve kërkohet shumica e të gjithë

²² European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), “*Opinion on the Sixth Revised Draft Act on Forfeiture of Assets Acquired through Criminal Activity or Administrative Violations of Bulgaria CDL-AD(2011)023*”. Paragrafi 17-9. (Shih linkun: [default.aspx](http://www.coe.int/default.aspx) (coe.int)). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës²³, përkundër se një përjashtim i tillë nuk është i specifikuar në Kushtetutë.

Në anën tjetër, as procedurialisht, Ligji për KPM nuk ka përcaktuar asnjë standard adekuat sa i përket përzgjedhjes së anëtarëve të KPM-së. Për shembull, në rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, Ligji Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese [neni 6, paragrafi 1 dhe 2] ka përcaktuar themelimin e një komisioni të posaçëm me përfaqësues ndërinstytucional, i cili komisioni i paraqet Kuvendit listën e ngushtë të kandidatëve të kualifikuar për Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Ndërsa, në rastin e anëtarëve të KPM-së, Ligji për KPM përcakton se e gjithë kjo procedurë zhvillohet nga një Komision Parlamentar, i përbërë vetëm nga përfaqësues politik.

Kështu, Qeveria, e cila ka shumicën në Kuvend, e ka në dorë si procedurën ashtu edhe votimin e anëtarëve të KPM. Kjo situatë qartazi e vendos KPM në mungesë të pavarësisë objektive për funksionimin e saj. Për këtë arsye, shumica e kërkuar dhe procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të KPM cenonjë pavarësinë kushtetuese që i garantohet KPM, duke e shndërruar këtë institucion të pavarur kushtetues në një institucion praktikisht vartës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Shkarkimi i anëtarëve të KPM-së

Me Ligjin aktual për KPM [neni 14] përcaktohet se për shkarkimin e një anëtari, propozimi vije nga vetë KPM, kurse Kuvendi me shumicë të thjeshtë votash vendos se a të shkarkohet ai/ajo anëtar/e, apo jo. Ndërkaq, sipas Ligjit të miratuar [neni 17] më nuk është KPM ajo që inicion shkarkimin e anëtarit. Në nenin 18 të këtij Projektligji përcaktohet se propozimi për shkarkim të kryetarit, apo anëtarit të KPM-së bëhet nga Komisioni Parlamentar përgjegjës për Media dhe pastaj Kuvendi me shumicë të thjeshtë votash vendos lidhur me atë propozim.

Përveç mundësisë së inicimit të shkarkimit të anëtarëve nga ana e Komisionit Parlamentar për Media, me Projektligj përcaktohen edhe rrethana shtesë se kur mund të bëhet ky inicim. Projektligji [neni 17.3, pika 4 dhe 5] ka përcaktuar se “Shkarkimi i anëtarit të KPM-së bëhet si rezultat i këtyre rrethanave:...marrjes pjesë në një proces vendimmarrjeje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut, apo njërit prej grupeve shoqërore që me këtë ligj KPM duhet të sigurojë mbështetje apo mbrojtje; humbje e besimit nga organi mbikëqyrës për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM”.

Përtej dispozitave që lejojnë politizimin e KPM me rastin e përzgjedhjes së tyre, procedura e shkarkimit dhe bazat e shkarkimit të anëtarëve të KPM-së sipas Ligjit e zhveshin KPM-në nga çdo pavarësi e funksionimit, duke e vendosur atë nën presion të vazhdueshëm ndaj Kuvendit. Kjo qasje e re në ligj, zhvlerëson tërësisht garancinë kushtetues mbi pavarësinë funksionale të KPM-së, duke marr kompetenca nga ky institucion i pavarur dhe duke ia deleguar deputeteve të partisë ose koalicionit qeverisës që ka shumicën në Kuvendin e Kosovës. Kjo mënyrë e

²³ Ligji NR. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 10.10.

rregullimit e bën lehtësisht të cenueshëm dhe të ndikueshëm KPM-në. Se sa mund të keqpërdoret kjo në praktikë, mjafton të shohim debatin, sulmet dhe kërkesat e deputetëve të partisë në pushtet në raportimin e anëtarëve të KPM-së në Komisionin Parlamentar për Media gjatë këtij viti.

Bazat për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së janë përcaktuar në mënyrë plotësisht të paqartë. Pjesëmarrja në një proces vendimmarrje në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut apo njërit prej grupeve shoqërore është kriter i përgjithshëm deri në nivelin e pazbatueshmërisë. Ky kriter mund të zbatohet vetëm përmes arbitraritetit. Shoqëruar kësaj shtate kriterin në lidhje me “humbjen e besimit” nga organi mbikëqyrës, e që është Komisioni Parlamentar, Ligji për KPM e ka shndërruar këtë institucion nga një institucion të pavarur kushtetues në një institucion tërësisht të varur nga mazhoranca politike në Kuvend. Madje, deri në nivelin që integriteti i anëtarëve të KPM-së të matet me nivelin e besimit që kanë anëtarët e komisionit parlamentar dhe lojalitetit që anëtarët e KPM kanë në raport me partinë në pushtet.

Kështu, bazat për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së paraqesin cenim thelbësor të sigurisë juridike, elemente thelbësore të së cilës siguri janë qartësia dhe parashikueshmëria e legjislacionit²⁴. Në këtë situatë dhe sipas këtij formulimi, anëtarët e KPM-së para se të kujdesen për detyrat e tyre, duhet të kujdesen për “nivelin e besimit” të anëtarëve të Komisionit parlamentar. Kjo situatë, pos që i vë të njëjtit në një situatë të pasigurisë së plotë juridike, e vendos KPM-në në një pozitë literalisht subordinuese ndaj Komisionit Parlamentar, përkundër faktit se KPM është institucion i pavarur Kushtetues.

Sa për krahasim, Kuvendi kishte iniciuar procedurën e ndryshimit të Kushtetutës, ku si bazë për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përcaktohej edhe “integriteti i cenueshëm”. Këtë bazë të shkarkimit, Gjykata Kushtetuese nuk e lejoi të miratohej as si ndryshim kushtetues. Për këtë situatë, Gjykata Kushtetuese theksoi se “Bazuar në parimet e lartcekura përkitazi me parimin e sigurisë juridike dhe rëndësinë e asaj që amendamentet kushtetuese duhet të jenë “të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”, sipas parimeve të përmbledhura nga raportet relevante të Komisionit të Venecias, Gjykata vlerëson që kriteri i “integriteti i cenueshëm” i përcaktuar përmes amendamenteve të propozuara kushtetuese nr. 27 dhe nr. 28, nuk e plotëson kriterin e “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” së normës kushtetuese. Kjo për faktin që hartuesi/propozuesi i këtij amendamenti të propozuar kushtetues nuk ka qartësuar se cilat rrethana përbëjnë “integritet të cenueshëm”, në mënyrë që të konstatohet se një rrethanë e tillë përbën “mosrespektim të rëndë të detyrave” së gjyqtarit/prokurorit”²⁵.

Përderisa “integriteti i cenueshëm” nuk u lejua të miratohej as si ndryshim kushtetues, Projektligji për KPM si bazë për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së e përcaktoi pjesëmarrjen në vendimmarrje që është në kundërshtim me interesat e KPM-së, publikut apo njërit prej

²⁴ European Commission for Democracy through law (Venice Commission) “Rule of law checklist”, faqe 25-26, maj 2016. (Shih linkun: https://www.venice.coe.int/images/site%20images/publications/rule_of_law_check_list.pdf). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024)..

²⁵ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO55/23, faqe 294 (Shih linkun: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2024/01/ko_55_23_agj_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 17 korrik 2024).

grupeve shoqërore si dhe humbjen e besimit nga Komisioni Parlamentar për shkak të cenimit të integritetit, qëndrimeve të anshme në favor të një pale të licencuar apo regjistruar në KPM. Këto baza për shkarkimin e anëtarëve të KPM janë tejet më të paqarta se “integriteti i cenueshëm”. Aplikimi i të njëjtave lejon arbitraritet të hapur derisa miratimi i tyre vë në presion të vazhdueshëm anëtarët e KPM-së.

Për këto arsye, dispozitat që kanë të bëjnë me procedurën e shkarkimit dhe bazat për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së cenojnë në thelb sigurinë juridike të anëtarëve të KPM-së dhe e shndërrojnë KPM-në nga një institucion të pavarur në një institucion literalisht vartës të Kuvendit. Kjo situatë pos cenimit të të drejtave individuale të anëtarëve të KPM-së cenon në thelb pavarësinë e kërkuar për institucionet e pavarura kushtetuese, ku bënë pjesë edhe KPM. Si të tilla, këto dispozita janë në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

8. Zgjedhja e Kryetarit

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM [neni 15.11], Kryetari i KPM-së zgjidhet nga radhët e anëtarëve të KPM-së. Ndërsa, sipas Ligjit për KPM [neni 15.1], Kryetari i KPM-së zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Zgjedhja e Kryetarit të KPM-së nga ana e Kuvendit dhe jo nga ana e KPM-së është një hap tutje për etablimin e politizimit të KPM-së nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit. Kjo praktikë është në kundërshtim me rregullat bazike të funksionimit dhe organeve kolegjiale, pavarësinë e KPM-së dhe ligjet e tjera në fuqi.

Fillimisht, duhet theksuar se Kryetari i KPM-së është “i pari në mesin e të barabartëve”. Kështu, nuk ka asnjë arsye që KPM, si një institucion i pavarur kushtetues, mos të ketë të drejtën të përzgjedhë kryetarin e saj, siç nuk ka asnjë arsye që zgjedhja e kryetarit të KPM-së të bëhet nga ana e Kuvendit.

Neni 38 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se "Përveç kur është paraparë ndryshe me ligj, organi kolegjial ka një kryetar dhe një nënkryetar, të cilët zgjidhen nga anëtarët e këtij organi...". Kështu, edhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si një ligj bazik në këtë fushë, ka përcaktuar të drejtën e organeve kolegjiale për të përzgjedhur Kryetarin e saj. Në këtë drejtim, IKD e ka parasysh se Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka karakter subsidiar dhe që përjashtime nga dispozitat e këtij Ligji mund të përcaktohen me Ligje të veçanta, sikurse në rastin tonë Projektligji për KPM. Megjithatë, neni 38 argumenton faktin se përzgjedhja e kryetarit të një organi kolegjial natyrshëm është e drejtë e organit kolegjial. Ndërsa, në rastin e KPM-së, nuk ka asnjë arsye për përjashtim.

Në anën tjetër, marrja e të drejtës së KPM-së për zgjedhjen e Kryetarit të saj nuk është e harmonizuar edhe me Ligje të tjera në fuqi. Për shembull, KGjK zgjedh Kryesuesin e saj²⁶,

²⁶ Ligji për KGJK, neni 11, paragrafi 1

ashtu si KPK²⁷. Po ashtu, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjedhin Kryetarin e kësaj Gjykate²⁸. Për këtë arsye, përcaktimi i të drejtës së Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit të KPM-së nuk është as në linjë me ligjet e tjera që rregullojnë organet kolegjiale.

Për këtë arsye, dispozitat e Ligjit për KPM të cilat i marrin këtij institucioni të drejtën për të zgjedhur Kryetarin e saj paraqesin cenim të KPM-së nga kompetencat e natyrshme të saj si institucion kolegjial dhe si institucion i pavarur kushtetues si dhe, pa ndonjë arsye të vlefshme, nuk janë në harmoni me ligjet e tjera të cilat rregullojnë organe të caktuara kolegjiale.

9. Si u politizua KPM?

Në bazë të elaborimit si më lartë, u argumentua se anëtarët e KPM-së zgjidhen lehtësisht nga partia e cila e ka mazhorancën parlamentare. Anëtarët e KPM-së zgjidhen përmes një procedurë të udhëhequr nga një Komision Parlamentar derisa votimi i tyre bëhet me shumicë të thjeshtë të votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Kështu, këto dispozita garantojnë një proces të lehtë për partinë që ka shumicën në Kuvend që ta politizojë përbërjen e KPM-së.

Në anën tjetër, përtej përzgjedhjes, Projektligji për KPM i la mundësi Kuvendit edhe të shkarkojë anëtarët e KPM-së, në secilin rast kur Komisioni Parlamentar humb besimin ndaj anëtarëve të KPM-së. Këto kritere, i mundësojnë shumicës parlamentare që në çdo kohë të ndryshojë përbërjen e KPM-së. Kjo situatë i vendos në presion të vazhdueshëm të gjithë anëtarët e KPM-së.

Tutje, roli i Kuvendit në KPM-së shtrihet deri në nivelin që edhe e zgjedh Kryetarin e saj, përkundër se kjo nuk ndodh me institucionet e tjera kolegjiale dhe përkundër faktit se kompetenca e KPM-së për zgjedhjen e Kryetarit të saj është kompetencë e natyrshme e një institucioni kolegjial.

Kështu, përderisa secila Qeveri e ka shumicën parlamentare në Kuvend, atëherë i bie se Qeveria në çdo kohë mund ta politizojë plotësisht KPM-në. Kjo duke përzgjedhur dhe shkarkuar lehtësisht anëtarët dhe Kryetarin e saj.

Kjo situatë e shndërron KPM-në në një institucion plotësisht vartës të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përballë këtyre dispozitave të Ligjit për KPM, humb edhe kuptimi i listimit të KPM-së si institucion i pavarur kushtetues. Kjo pasi Ligji për KPM nuk i lë KPM-së asnjë kompetencë përmes të cilave do të kishte mundësi që në mënyrë adekuate të ushtronte pavarësinë e saj në raport me obligimet që ka.

Kështu, Ligji për KPM politizon plotësisht këtë institucion të pavarur kushtetues. Ky politizim është në kundërshtim të hapur me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të elaboruar në këtë analizë.

²⁷ Ligji për KPK, neni 11, paragrafi 1.

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 114, paragrafi 5.

10. Cenimi i barazisë gjinore

Në Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media [neni 4.5.] përcaktohet se nga gjithsej shtatë anëtarë të KPM-së, të paktën dy prej tyre duhet të jenë të gjinisë femërore.

Mirëpo, një kriter i tillë është larguar tashmë nga Ligji për KPM. Ky Ligj [neni 13.6 dhe 14.2.] përcakton se *“Përbërja e anëtarëve të KPM-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku tre (3) anëtarë të KPM-së emërohen nga radhët e komuniteteve jo shqiptare”* si dhe *“Zgjedhja e kryetarit dhe anëtarëve të KPM-së reflekton parimet e barazisë gjinore sipas legjislacionit përkatës për barazi gjinore”*.

Në këtë dispozitë vërehet qartazi edhe kontradikta sa i përket parimit të barazisë gjinore. Thuhet se përbërja e KPM-së pasqyron edhe karakterin gjinor të Kosovës, ndërsa nuk përkufizohet numri minimal i anëtarëve të gjinisë femërore. Kurse, ndryshe është vepruar me përkufizimin e numrit minimal të anëtarëve që duhet të jenë nga komunitet jo shumicë, ku specifikisht është përcaktuar numri i anëtarëve të komuniteteve jo shumicë që duhet të përfaqësohen në Kuvend.

Sa i përket referimit në legjislacionin për barazi gjinore, si tendencë për të arsyetuar përfaqësim të barabartë gjinor, kjo nuk qëndron. Kjo pasi Projektligji për KPM i referohet përgjithësisht dhe jo specifikisht Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Kjo duke përmendur *“parimet”* dhe jo *“përfaqësimin e barabartë”*.

Sipas Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore [neni 6.8] *“Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”*. Megjithatë, për tu arritur përfaqësimi i barabartë, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore ka përcaktuar masat e veçanta [neni 6.2.1.], ku, ndër të tjera, përfshihet përcaktimi i kuotës për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve.

Për këtë arsye, nuk është i mjaftueshëm referimi abstrakt në legjislacionin për barazi gjinore. Kjo qasje, ligjërisht, nuk garanton përfaqësim proporcional gjinor në KPM. Në vend të një referimi abstrakt, Ligji është dashur të specifikoj numrin e saktë të grave që duhet të jenë anëtare të KPM.

Mos përkufizimi i numrit minimal të anëtarëve të gjinisë femërore, krijon mundësinë që në përbërjen e këtij Komisioni të mos jetë asnjë grua. Projektligji për KPM nuk ofron mundësinë që një konkurs në të cilin kriteret plotësohen vetëm nga burrat të anulohet për shkak të përfaqësimit gjinor. Kjo pasi një dispozitë e tillë i mungon Ligjit ? për KPM derisa referimi në legjislacionin për barazi gjinore është vetëm në abstrakt.

Kështu, mos inkorporimi i dispozitës që përcakton numrin minimal të anëtarëve gra në KPM cenon parimet e barazisë gjinore të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Për më tepër, në këtë situatë, Projektligji për KPM, në raport me Ligjin Nr.04/L-44 për KPM, paraqet regres sa i përket barazisë gjinore.

Raporti “Politizimi i KPM-së”, (Analizë e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave), është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund.



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

